



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI

Sesioni pranveror

Kuvendi i Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 52, paragrafi 2 i Rregullores së Kuvendit, pas debatit të zhvilluar në seancën plenare të mbajtur më 30 maj 2018, me propozimin e Grupit Parlamentar të Partisë Socialdemokrate, miratoi këtë:

REZOLUTË

Për heqjen e Roamingut ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë

1. Qeveria e Republikës së Kosovës, në kuadër të integritimit ekonomik me Qeverinë e Republikës së Shqipërisë, të nis procedurat për arritjen e marrëveshjes për heqjen e tarifave të roamingut në telefoninë mobile ndërmjet qytetarëve të dy vendeve respektive.
2. Të themelohet Komisioni i Përbashkët Qeveri-Kuvend për fillimin e bisedimeve për eliminimin total të tarifave të roamingut në Kosovë dhe Shqipëri. Anëtarët nga Kuvendi pjesë e këtij komisioni janë përfaqësuesit e secilit grup parlamentar në legjislaturën aktuale.
3. Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare i Kosovës dhe Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare i Shqipërisë të përkujdeset për implementimin e marrëveshjes së arritur.
4. Të thellohet bashkëpunim në fushën e komunikimeve elektronike, me theks të posaçëm në shkëmbimin e trafikut të internetit drejtpërdrejtë ndërmjet njejve shkëmbyese të internetit (Internet Exchange Point -IXP) të dy vendeve.
5. Komisioni i përbashkët të raportojë në Kuvend për arritjen e marrëveshjes dhe ecurinë e eliminimit të tarifave jo më larg se dy muaj nga miratimi i kësaj rezolute.

Nr. 06-R-004

Prishtinë, më 30.05.2018

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

Rezoluta u dërgohet:

- Qeverisë së Republikës së Kosovës,
- Grupeve parlamentare, dhe
- Arkivit të Kuvendit.